

## Komuna e Shtërpcës/Štrpce

### Sladan (Ratko) Popović

(21.07.1971, serb nga Naklla/Naklo, komuna e Pejës/Peć, i pamartuar, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Pas përfundimit të shkollës së mesme dhe shërbimit ushtarak, Sladani ka punuar për gjashtë muaj në postën e Pejës/Peć. Pastaj, e vijoi trajnimin për oficer policie në Vushtrri/Vučitrn. Nga viti 1992, punonte në SHPB-në e Klinës/Klina. Në datën **27.09.1998**, Sladani me njësitin e tij po e kontrollonin pyllin përmbi fshatin **Studenicë/Studenica**. Papritmas, polici Slavoljub Đurišić u plagos nga snajperi. Kur Sladani deshi t'i ndihmonte, edhe ai u qëllua në qafë nga pushkë snajperi. Ka dhënë shpirt menjëherë. Sladani u varros më 28.09.1998 në varrezat e fshatit të vet. Pas 40 ditësh, e ëma i ka rivarrosur të birin dhe bashkëshortin në vendin ku i kishte ngritur varrezat familjare.

**Burimet:** deklarata S.P, FDH-27954; KMKKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 54; SMIP, *Teroristički...*, III, 525, 940.

### Daut (Avdulla) Rexhepi

(12.03.1958, shqiptar nga Viqa/Viča, komuna e Shtërpcës/Štrpce, i pamartuar, katër fëmijë)

Dauti ka punuar si oficer policie deri më 25.03.1990. Së pari ka punuar në Stacionin Policor të Mitrovicës/Kosovska Mitrovica, ndërkaq më vonë ka punuar edhe në Ferizaj/Uroševac. Para muajit mars të vitit 1990, ka qenë komandant i Stacionit Policor në fshatin Babushë/Babuše. Ka qenë i martuar me Nexhmijen dhe i kishin dy djem dhe dy vajza. Jetonin

në shtëpinë e përbashkët me prindërit dhe vëllain e Dautit. Në muajin maj të vitit 1988, në fshatrat e komunës së Shtërpcës/Štrpce u paraqiten grupet e armatosura që e patrullonin rajonin. Një grup i tillë e ka vendosur më 27.09.1998 një postbllok në udhëkryq te ura mbi lumin Lepenc/Lepenac. Për këtë arsye, në mëngjesin tjetër [**28.09.1998**], nga ora 7:30, Dauti u nis me fëmijët që t'i shoqëronte deri te shkolla në fshatin Drajkoc/Drajkovce. Por, nga ora 8:00, pjesëtarët e forcave serbe që arritën në **Viqë/Viča**, filluan me bastisjen e shtëpive shqiptare. E bastisën edhe shtëpinë e Dautit. Nga ora 10:00, babai dhe vëllai i Dautit, së bashku me axhën e tij, dolën për ta kërkuar atë. Nga komshiu serb mësuan se policia e kishte çuar Dautin në Stacionin e Policisë të Shtërpcës/Štrpce. Shkuan atje, por policët i përzunë me ofendime të rënda. Atëherë, i vëllai i Dautit ka shkuar te një serb, i cili ishte mik familjar, dhe së bashku me të vajtën në Stacionin e Policisë. Komandanti i stacionit, i cili ishte kolegu i dikurshëm i Dautit [identiteti i tij është i njohur për FDH], u tha se fati i Dautit tani varet nga një inspektor i Shërbimit të Sigurimit [identiteti i tij është i njohur për FDH]. Më pas, ky inspektor u tha se Dautin nuk e kishte marr policia. Ai e kërcënoi Nazmiun se edhe ai do të shkonte “në bodrum” nëse vazhdonte të interesohej për të vëllain. Familjarët kanë pritur atë ditë që fëmijët të kthehen nga shkolla dhe pastaj kaluan dhe u strehuan në Ferizaj/Uroševac. Interesoheshin gjithandej dhe tërë kohën për Dautin, por pa sukses. Pas pesë ditësh, më 2.10.1998, banorët e fshatit